



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	20.12.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMESHICK	7585/2023		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.nr.1380/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1380/2023, të datës 06.11.2023, të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit: Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.12.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

**Hedhet poshtë si e parakohshme** ankesa me numër A.nr.1380/2023, e datës 06.11.2023, e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi (me tej vetëm ankuesi) me datë 06.11.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mbarëvajtjes së procedurave të rekrutimit me numër të referencës RN00012073 lidhur me emrin e grupit “Specialist të Administrimit të Përgjithshëm - Inspektor i tregut në Ministrinë e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë”, me pretendimet ankimore se ky proces rekrutues është i përfshirë me: shkelje të procedurave dhe shpalljeve prej Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), vlerësimit jo të drejtë prej komisionit të caktuar për shpalljen me Nr. Reference RN00012073.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 09.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit, më datë 15.11.2023, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 6873/2023 të datës 06.11.2023 e parashtruar nga ankuesi në



Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Diplomën e ankuesit me Nr.680/19 të datës 10.06.2019 nga Kolegji AAB; Certifikatën e ankuesit nga S.h.p.k Pixels të datës 09.06.2017; Certifikatën e ankuesit nga S.h.p.k Pixels të datës 27.10.2017; Kartelën e nëpunësit-ankuesit tek OSCE; Kartelën e nëpunësit-ankuesit tek Newsweek; Shkresën zyrtare të ankuesit të datës 11.04.2000 tek UNMIK; Konfirmimin e datës 29.06.2000 lidhur me NTSHH Swim-and-smile nga UNMIK; Certifikatën e regjistrimit me numër 80247907 të datës 04.11.2004 nga MTI së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur; Certifikatën e regjistrimit të biznesit me numër 811487124 të datës 16.11.2009 nga ARBK-MTI; Marrëveshjen për shërbime të veçanta të datës 10.05.2019 ndërmjet ankuesit dhe MTI-së; Marrëveshjen për shërbime të veçanta të datës 15.01.2020 ndërmjet ankuesit dhe MTI-së; Marrëveshjen për shërbime të veçanta të datës 26.06.2020 ndërmjet ankuesit dhe MTI-së; Kontratën e punës me numër Nr.673 të ankuesit të datës 08.02.2021 ndërmjet ankuesit dhe MTI-së; Kontratën e punës të datës 01.12.2021 ndërmjet ankuesit dhe Vita land L.L.C; Pasqyrën e llogarisë së trustit të ankuesit për periudhën nga data 01.08.2022-14.14.07.2023; Shkresën zyrtare mbi listën e pagave me numër Nr.3212/2023 të datës 25.07.2023 nga ATK; Referencën nga Vitaland për ankuesin; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Raportin e punës të datës 08.03.2021; Vërtetimin e marrëdhënies së punës të datës 02.08.2023; Deklaratën nën betim të datës 25.07.2023; Vërtetimin e datës 25.07.2023 nga Policia e Kosovës; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 19.07.2023; Gjendjen e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera nga ATK; Komunikimet elektronike të datës 04.08.2023, 11.08.2023, 29.08.2023, 11.09.2023, 20.09.2023, 05.10.2023, 24.10.2023, 31.10.2023, 19.10.2023 ndërmjet ankuesit dhe zyrtarëve të DMZP-së; Konkursin me numër të referencës RN00012073 të datës 14.07.2023; CV-në e ankuesit; Vendimin me Nr.Prot.1320 të datës 25.08.2023 lidhur me shtyrjen e afatit për përfundimin e verifikimit paraprak nga DMZP-ja; Vendimin me Nr.1676/2023 të datës 10.10.2023 për shtyrje të afatit për përfundimin e procedurave të rekrutimit nga DMZP-ja; Njoftimin e datës 19.09.2023 lidhur me ndryshimin e listës së ngushtë; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.11.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 15.11.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike-MPB së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës dhe atë: Vendimin me Nr.02/164 të datës 09.10.2023 lidhur me emërimin e Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Publike; Listën e aplikantëve të gjeneruar tek SIMBNJ; Njoftimin e datës 11.09.2023 lidhur me listën e ngushtë nga DMZP-ja; Njoftimin e datës 19.09.2023 lidhur me ndryshimin e listës së ngushtë nga DMZP-ja; Formularët mbi vlerësimet përfundimtare të anëtarëve të komisionit për ankuesin; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 07.11.2023 e gjeneruar tek SIMBNJ; Njoftimin e datës 09.11.2023 mbi kandidatët fitues nga DMZP-ja; Vendimin me Nr.1975 të datës 17.11.2023 të Komisionit të Pranimit si dhe Njoftimin e datës 09.11.2023 nga DMZP-ja për ankuesin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se është e parakohshme ankesa e ankuesit, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se njësia përgjegjëse-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me datë 14.07.2023, ka publikuar Konkursin për pranim, me numër reference RN00012073, për emrin e grupit "Specialistë i Përgjithshëm", me titull të vendit të punës "Inspektor i Tregut", Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Klasa profesional 1, njëzeteshtatë (27) vende. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 04.08.2023 deri me datë 11.08.2023, e në të cilin, ka aplikuar edhe ankuesi me datë 09.08.2023, sipas aplikacionit RAN0016733.

Në fazën e vlerësimit përfundimtar të procedurës, njësia përgjegjëse me datë 09.11.2023 ka shpallur njoftimin lidhur me kandidatët fitues sipas të cilit si kandidatët me më së shumti pikë janë renditur si në vijim: kandidati me gjithsej 76.8 pikë, kandidati me gjithsej 75 pikë, kandidatja i me gjithsej 74.8 pikë, kandidata me gjithsej 74 pikë, kandidati me gjithsej 73.8 pikë, kandidati me gjithsej 70.2 pikë dhe kandidati me gjithsej 70.2 pikë, ndërsa sipas renditjes përfundimtare të datës 07.11.2023, të



Komisionit të Pranimit, ankuesi është vlerësuar 48 pikë në testin me shkrim, 7 pikë të jetëshkrimi dhe 0 pikë në intervistën me gojë, gjithsej 54 pikë.

I pakënaqur me vlerësimin e Komisionit të Pranimit, ankuesi me datë 06.11.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ky proces rekrutues është i përfshirë me: shkelje të procedurave dhe shpalljeve prej Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), vlerësimi jo të drejtë prej komisionit të caktuar për shpalljen me Nr. Reference RN00012073.

Në kuptim të pranueshmerinë së ankesës, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 25 paragrafi 4, 5 dhe 6 me të cilin është përcaktuar se: *"..4 .Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatin e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit. 5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual. 6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj...."*, si dhe nenin 31 paragrafin 1 dhe 2 të kësaj rregullore më të cilin parashihet se: *1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") "4. Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës"* dhe si rrjedhojë mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi ende pa i shterur mjetet juridike të brendshme konkretisht pa parashtruar ankesë fillimisht tek Komisioni i Pranimit, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që mbi bazën e këtyre rrethanave ankesa e ankuesit me numër A.nr.1380/2023 e datës 06.11.2023 e ushtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e parakohshme dhe si e tillë nuk përmbush elementet e pranueshmerisë në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si më sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1380/2023

Ardita Pircuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.